



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr.345/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Zyhdi Haziri dhe Faton Ademi anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Arjeta Sylja, duke vendosur përkritazi me ankesën e Rrjetit Ballkanik Për Gazetari Hulumtuese BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, dega në Skenderaj, për shkak të Thyerjes së Heshtjes Zgjedhore, për Zgjedhjet Lokale 2017 të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 24.10.2017, mori këtë:

#### V E N D I M

**HUDHET** si e pa rregullt ankesa e Rrjetit Ballkanik Për Gazetari Hulumtuese BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë me shenjë ZL.Anr.345/2017 e datës 22.10.2017, e parashtruar kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, dega në Skenderaj.

#### A r s y e t i m

Me datën 22.10.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Rrjeti Ballkanik Për Gazetari Hulumtuese BIRN dhe Internews Kosova, me të cilën ka pretenduar se kandidatja për anëtare të Kuvendit Komunal të Skenderajit, nga subjekti politik LVV-së, Albina Gashi, në rrjetin social facebook me datën 22 tetor 2017 rreth orës 14:57 minuta ka shpërndarë fotografi të saj me logon dhe numrin e subjektit politik LVV, duke bërë thirrje për ta votuar. Parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelja e nenit 36 par.1 pika a) dhe b) të LZP-së. Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur dy fotografi në lidhje me rastin në fjalë.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të rregullsisë së ankesës gjeti se:

#### **Ankesa është e pa rregullt**

PZAP-i, nga shkresat e lëndës vlerësoi se ankesa e parashtruar nga ana e BIRN dhe Internews Kosova është e parregullt, sepse nuk është e nënshkruar nga parashtruesi i ankesës dhe si e tillë ankesa nuk i plotëson kërkesat e Rregullës Nr.02/2015 të nenit 5.6 ku përcaktohet se: *“Ankesat duhet të dorëzohen me shkrim dhe duhet të jenë të nënshkruara nga ankuesi apo në emër të tij nga i autorizuari”*.

Prandaj, PZAP-i nuk u lëshua fare në meritat e ankesës, ngase nuk janë plotësuar kushtet e kërkuara nga dispozita e lartëtheksuara.

Nga arsyet e sipërshënuar e në mbeshtejte të nenit 6.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it dhe në kuptim të dispozitës së nenit 118.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
ZL Anr.345/2017 më datën 24.10.2017.

**Kryesuesi i Panelit**  
**Rafet Haxhaj**



**Këshillë juridike:** *Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.*